



Rruga Elbasanit, Tiranë – Shqipëri Tel/Fax: ++ 3554 345 789

Njoftim për Aplikim në Master Shkencor dhe Profesional

Njoftohen studentët që në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, kanë filluar aplikimet për regjistrime në Ciklin e Dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” për vitin akademik 2016-2017.

Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” do të kryhen në sallën B102, tek Laboratorët, kati i parë, Godina B. Aplikimet fillojnë në datën **05.10.2016** deri në **19.10.2016**, dhe do të vijojnë çdo ditë prej orës **08:00** deri më **16:00**.

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë kandidatët që:

- a. kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezultoi i akredituar në momentin e diplomimit të studentit.
- b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë Bachelor ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.

2. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;
- b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr.876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave. “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike (të ndryshuar)”, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinale ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA)

Në rast se kandidatët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të Vendimit të KM Nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 78, datë 8.2. 2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike (të ndryshuar), dhe kanë dhënë me sukses (me rezultate kaluese) provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore, paraqesin edhe dokumentacionin përkatës të lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Provimeve.

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), dokumentacionin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave. Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga AKP, të shoqëruar me fotokopje të njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë, të përkthyer në gjuhën shqipe, nëse është lëshuar në gjuhë të huaj, të diplomës së Maturës Shtetërore të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendorë apo qendrorë, të vendit ku ka përfunduar studimet, të njohuara në Republikën e Shqipërisë ose të një dokumenti të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente mbi bazën e të cilit është kryer njohja nga MAS;

c. Formulari i aplikimit mbi përzgjedhjen e masterave [KLIKO KËTU](#);

d. Deklaratën e aplikantit [KLIKO KËTU](#);

e. Mandat pagesa e tarifës së aplikimit prej 2.500 lekë (për të gjithë kandidatët);

f. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

g. Dy fotografi personale;

h. Fotokopje e noterizuar e gjuhës së huaj (vetëm për Masterin Shkencor), sipas Udhëzimit Nr. 52, Dt. 03.12.2015 të MAS

Kriteret dhe Politikat e Përzgjedhjes:

A. Kriteri bazë i përzgjedhjes për shpalljen e fituesve:

1. Mesatarja e përgjithshme e ponderuar e studimeve bachelor brenda kuotave të miratuara.

B. Politika e Përzgjedhjes bazohet në përparësitë e mëposhtme:

1. Së pari, përparësi kanë aplikantët e diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetet e tjera të UT (sipas pikës c të mëposhtme);
2. Së dyti, përparësi kanë aplikantët e diplomuar në universitetet e huaja;
3. Së treti, aplikantët e diplomuar në universitetet publike me profil ekonomik;
4. Së katërti, aplikantët e diplomuar në universitetet publike me profil jo ekonomik;
5. Së pesti, aplikantët e diplomuar në universitete private.

C. KUSH MUND TË APLIKOJË?

1. Për Master Shkencor Ekonomiks (MSHE) dhe Master Profesional Studime Ekonomike Europiane (MPSEE) gëzojnë të drejtën e aplikimit:
 - Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet universitare në FEUT që kanë të paktën një diplomë bachelor.
 - Të gjithë aplikantët që kanë një diplomë bachelor në fakultetet e tjera ekonomike, si dhe në degët matematikë, fizikë, informatikë, inxhinieri, të marra nga institucione të arsimit të lartë publike ose jopublike, të huaja ose vendase, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.
2. Për Masterin Shkencor në Administrim Biznesi (MSHAB), gëzojnë të drejtën e aplikimit:
 - Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degët përkatëse.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit, të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Agro-Biznes të fakulteteve të tjera të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe departamentit dhe udhëzimeve përkatëse të MAS.

Për Masterin Profesional në Administrim Biznesi (MPAB), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degët përkatëse.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Agro-Biznes të fakulteteve të tjera të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, si edhe të profileve inxhinierike, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.

Për Masterin Shkencor në Administrim Publik (MSHAP), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degët përkatëse.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Punë Sociale, Juridik dhe Agro-Biznes të fakulteteve të tjera të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe departamentit dhe udhëzimeve përkatëse të MAS.

Për Masterin Profesional në Administrim Publik (MPAP), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degët përkatëse.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Shkenca Sociale, Shkenca Politike, Drejtësi dhe Agro-Biznes të fakulteteve të tjera të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit.

3. Për Masterin Shkencor dhe Master Profesional në Kontabilitet dhe Auditim (MSHKA dhe MPKA) mund të aplikojnë:
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në FEUT që kanë të paktën një diplomë bachelor në Financë – Kontabilitet dhe Administrim Biznes.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike ose jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe sipas së njëjtës preference të paraqitur më sipër.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Informatikë Ekonomike, Ekonomiks të Fakultetit të Ekonomisë UT si dhe Administrim Biznesi të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike ose jopublike, vendase e të huaja, pas plotësimit të njohurive të tyre formuese dhe pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe departamentit.
4. Për Masterin Shkencor në Financë (MSHF), Master Profesional në Financë (MPF, 120 kredite), Master Profesional në Bankë, Master Profesional në Sigurime (MPS, 60 kredite) dhe Master Profesional në Financat e Ndërmarrjes (MPFN, 60 kredite) mund të aplikojnë:
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në FEUT që kanë të paktën një diplomë bachelor në Financë – Kontabilitet dhe Administrim Biznes.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në degët Ekonomiks dhe Informatikë Ekonomike të Fakultetit të Ekonomisë, UT, pas plotësimit të njohurive të tyre formuese.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Financë - Kontabilitet dhe Administrim Biznesi në fakultete të ekonomisë (publike/ jopublike –vendase/ të huaja) mund të pranohen pasi të jetë kryer njohja e diplomave të tyre sipas rregullores përkatëse të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Për Masterin Profesional në Financë, Kontabilitet dhe Auditim (MPFKA, 60 kredite), mund të aplikojnë:

- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në FEUT që kanë të paktën një diplomë Bachelor në Financë – Kontabilitet.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në degën Administrim Biznesi të Fakultetit të Ekonomisë, UT, pas plotësimit të njohurive të tyre formuese.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Financë - Kontabilitet në fakultete të ekonomisë (publike/ jopublike –vendase/ të huaja) mund të pranohen pasi të jetë kryer njohja e diplomave të tyre sipas rregullores përkatëse të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.
5. Për Masterin Shkencor në Sisteme Informacioni në Ekonomi (MSHSIE), Master Shkencor në “Siguria e Informacionit” (MSHSigIn), dhe Master Profesional në Sisteme Informacioni në Ekonomi (MPSIE), gëzojnë të drejtën e aplikimit:
- Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degën Informatikë Ekonomike.
 - Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Informatikë, Teknologji Informacioni të FSHN, UT, Inxhinieri Informatike dhe Inxhinieri Elektronike të UPT, dhe të gjitha diplomat Bachelor të fakulteteve të tjera publike ose jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe që përkojnë me formimet e mësipërme ose të ngjashme me to.
 - Të gjitha diplomat bachelor në Ekonomiks, Administrim Biznesi dhe Financë të Fakultetit të Ekonomisë, UT.

Për Masterin Profesional në Teknologji Informacioni dhe Menaxhimi i Proceseve të Biznesit (MPTIMPB), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degën Informatikë Ekonomike.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Informatikë, Teknologji Informacioni, Matematikë të FSHN, UT, Inxhinieri Informatike dhe Inxhinieri Elektronike të UPT, dhe të gjitha diplomat bachelor të fakulteteve të tjera publike ose jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe që përkojnë me formimet e mësipërme ose të ngjashme me to.

- Të gjitha diplomat bachelor në Ekonomiks, Administrim Biznesi dhe Financë të Fakultetit të Ekonomisë, UT si dhe degë të ngjashme me to.

Për Masterin Shkencor Kërkime Operacionale në Menaxhim (MSHKO), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë aplikantët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degët Informatikë Ekonomike, Administrim Biznes, Financë – Kontabilitet dhe Ekonomiks.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Informatikë, Teknologji Informacioni, Matematikë të FSHN, UT, Inxhinieri Informatike dhe Inxhinieri Elektronike të UPT, dhe të gjitha diplomat Bachelor të fakulteteve të tjera publike ose jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe që përkojnë me formimet e mësipërme ose të ngjashme me to.

6. Për Masterin Shkencor në Marketing (MSHMR), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degën Administrim Biznes.
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në degët e tjera të Fakultetit të Ekonomisë, UT.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Agro- Biznes, të fakulteteve të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit dhe departamentit dhe udhëzimeve përkatëse të MAS.

Për Masterin Shkencor në Turizëm (MSHTU), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degën Administrim Biznes.
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në degët e tjera të Fakultetit të Ekonomisë, UT.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Punë Sociale, Juridik dhe Agro- Biznes, Inxhinieri, Filologji dhe të fakulteteve të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit dhe departamentit dhe udhëzimeve përkatëse të MAS.

Për Masterin Profesional në Marketing (MPMR), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degën Administrim Biznes.
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në degët e tjera të Fakultetit të Ekonomisë, UT.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Agro- Biznes të fakulteteve të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, si dhe të profileve inxhinierike, shkencave sociale, të gjuhëve të huaja, histori, gjeografi etj, këto pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit. Në varësi të rregullores së FEUT, mund të kërkohen njohuri formuese ekonomike për disa profile të caktuara.

Për Masterin Profesional në Turizëm (MPTU), gëzojnë të drejtën e aplikimit:

- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në FEUT në degën Administrim Biznes.
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në degët e tjera të Fakultetit të Ekonomisë, UT.

- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në fushën e ekonomisë dhe të biznesit të fakulteteve të tjera ekonomike të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Shkenca Sociale, Shkenca Politike, Drejtësi, Agro-Biznes, Shkencave Inxhinierike të fakulteteve të ekonomisë të shkollave publike dhe jopublike, vendase e të huaja. Në të gjitha këto raste, pranimi i studentëve kërkon paraprakisht njohjen e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

Për çdo informacion shtesë mund të drejtoheni në Departamentin përkatës të FEUT, që mbulon Programin Master për të cilin ju aplikoni!